



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - Vlada KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA - MINISTRY OF HEALTH
REPUBLICAN CHIEF MEDICAL OFFICER - REPUBLICAN CHIEF OF PUBLIC HEALTH
REPUBLICAN CHIEF OF PHARMACEUTICAL INSPECTION

Objekti Org.
Org. Jedinica
Org. Unit - 10 -

No. i fletës
Fol. 6 -

No. Prot.
Prot. No. 05-459

Datë
Date 14 04 25

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Inspektorati Farmaceutik/Farmaceutski Inspektorat/Pharmaceutical Inspectorate

Raport		
Data/Date/Datum:	08.04.2025	Ref. No. 10/KI-006-25
Për/To/ Za:	Znj. Albana Islamaj, pronare e barnatores "Pharmacy AN & BI", me adresë: Rruga "Tahir Sinani" Nr. 150, Prizren.	
Përmes/Through/Preko:	Znj. Remzie Thaçi, Drejtoreshë e Inspektoratit Farmaceutik	
Nga/From/Od:	Kaltrina Islamaj, Inspektore Farmaceutike Leonis Blakaj, Inspektor Farmaceutik	
Lënda/ Subject/Tema:	Raport i inspektimit për Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale "Pharmacy AN & BI", Prizren.	
Cc:	Z. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë; Z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i MSh-së; Z. Labinot Zeqiri, Zëvendësues i Detyrës së Kryeinspektorit Shëndetësor; Z. Arian Ahmeti, Zëvendësues i Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në AKPPM.	

I. Përmbledhja

Duke u bazuar në autorizimin (Miratimin) për inspektim dhënë nga drejtoresha e Inspektoratit Farmaceutik, me datë 13.03.2025 nga ora 11:10 deri në orën 11:30, Inspektorati Farmaceutik ka kryer inspektim në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (Barnatoren) "Pharmacy AN & BI" në Prizren.

Objekti i inspektimit ishte verifikimi se, barnatorja në fjalë a është duke operuar, pas kërkesës përmes shkresës elektronike nga subjekti në fjalë për shtyrjen e inspektimit të planifikuar. Praktika e Mirë Farmaceutike për të cilin ishte njoftuar paraprakisht në afatin kohor të paraparë me ligj, njoftim ky që u bë nëpërmjet telefonit dhe E-mailit Zyrtar dhe u konfirmua nga përfaqësuesja e subjektit në fjalë. Kërkesa për shtyrje të inspektimit u bë në datë 13.03.2025 në ora 08:19, datë e cila ishte planifikuar të mbahej inspektimi. Kërkesa nga ana e subjektit në fjalë

u bë me arsyejen se, nuk mund ta mbaj barnatoren e hapur për shkak se farmacistja është në pushim.

Barnatorja u gjet e hapur dhe prezent ishte vetëm tekniku i farmacisë z. Bejtulla Islamaj.

Inspektimi u bazua në Ligjin 08/L-067 për Inspektime (GZ, Nr. 2, 18 janar 2022), Ligjin 04/L-125 për Shëndetësi (GZ, Nr. 13, 07 maj 2013), Ligjin 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale (GZ, Nr. 27, 25 prill 2014), Ligjin 05/L-087 për Kundërvajtje të Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 33, 8 shtator 2016) dhe Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) Nr. 11/2015 për Qarkulluesit me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Në fund të inspektimit u përpilua Procesverbali me numër serik 0005478, i cili i është lexuar Palës dhe është nënshkruar nga Pala prezentë pa ndonjë pretendim apo vërejtje, si dhe nga Trupa Inspektuese.

II. Metodologjia

Metodat e përdorura gjatë inspektimit:

- **Intervistimi:** Bashkëbisedimi me z. Bejtulla Islamaj, teknik i farmacisë.
- **Mbledhja e fakteve:** Licenca e Barnatores, Certifikata e Biznesit, Licenca e Farmacistit Përgjegjës, Licenca e Teknikut të Farmacisë.
- **Observimi:** Gjatë inspektimit janë kontrolluar dokumentacioni si dhe prezenca e stafit profesional.

III. Faktet

Duke u bazuar në autorizimin (Miratimin) për inspektim dhënë nga drejtoresha e Inspektoratit Farmaceutik, me datë 13.03.2025 nga ora 11:10 deri në orën 11:30, Inspektorati Farmaceutik ka kryer inspektim në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (Barnatoren) "Pharmacy AN & BI" në Prizren.

Objekti i inspektimit ishte verifikimi se, barnatorja në fjalë a është duke operuar, pas kërkesës përmes shkresës elektronike nga subjekti në fjalë për shtyrjen e inspektimit të planifikuar. Praktika e Mirë Farmaceutike për të cilin ishte njoftuar paraprakisht në afatin kohor të paraparë me ligj, njoftim ky që u bë nëpërmjet telefonit dhe E-mailit Zyrtar dhe u konfirmua nga përfaqësuesja e subjektit në fjalë. Kërkesa për shtyrje të inspektimit u bë në datë 13.03.2025 në ora 08:19, datë e cila ishte planifikuar të mbahej inspektimi. Kërkesa nga ana e subjektit në fjalë u bë me arsyejen se, nuk mund ta mbaj barnatoren e hapur për shkak se farmacistja është në pushim.

Barnatorja u gjet e hapur dhe prezent ishte vetëm tekniku i farmacisë z. Bejtulla Islamaj me numër të licencës së punës KO-24660-05-4.

Përmes Procesverbalit me numër 0005478, Pala është urdhëruar të punoi sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

IV. Konstatimet

- Barnatorja "Pharmacy AB & BI", Rruga "Pharmacy AN & BI", Prizren, e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), me Numër Unik Identifikues 811556789 dhe në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) me Numër të Licencës L5-0229/30/04/2021, me pronare znj. Albana Islamaj dhe me farmacistë përgjegjës znj. Besarta Bajraj me numër të licencës së punës RKS-1054-21 posedon licencë valide të veprimtarisë.
- Në kohën e inspektimit në barnatore nuk ishte prezent farmacistja përgjegjëse dhe as ndonjë farmacist tjetër zëvendësues, me ç'rast konstatohet se pala ka vepruar në


kundërshtim me nenin 14 (paragrafin 2) të Ligjit 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, që përcakton: *"Barnatorja duhet të ketë gjatë gjithë orarit të punës farmacist/farmacistët e licencuar."*, nenin 26 (paragrafin 2) të Ligjit 04/L-125 për Shëndetësi, që përcakton: *"Barërat e përshkruara nga mjeku ose stomatologu mund të jepen vetëm nga ose në prezencën e farmacistit të licencuar."*, neni 6 (paragrafët 3 dhe 4) të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 11/2015 për Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale, që përcakton: *"Barnatorja mund të funksionojë vetëm në prezencë të farmacistit."* dhe *"Në rast kur farmacisti nuk mund të jetë prezent në barnatore, bariësi i licencës profesionale të barnatores është i obliguar që ta angazhojë farmacistin zëvendësues, i cili autorizohet për kryerjen e detyrave të farmacistit."*

V. Rekomandimet

- Urdhërohet që në barnatore të operohet vetëm sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- Raportin e shoqëron Vendimi me gjobë numër 10/KI-006-25.
- Për plotësimin e rekomandimeve Pala të njoftojë me shkrim Inspektoratin Farmaceutik.

Raportit i bashkëngjitet :

Kopja e Procesverbalit me numër serik 0005478, si dhe kopja e shkresës zyrtare si dëshmi.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Inspektorati Farmaceutik

PROCESVERBAL I INSPEKTIMIT

0005478

(Nr. Serik)

13.03.2025

(Data e fillimit të inspektimit)

11:10

(Ora e fillimit të inspektimit)

Në subjektin:

Banalore Pharmacy ANEBI N.L: LS-0223/30/04/202

(Emërtimi i subjektit të inspektimit)

Nr. APBK: 81/1586

I udhëhequr nga:

Albana Islami - Pionere

(Emri dhe mbiemri i udhëheqësit të subjektit të inspektimit)

Në adresën:

Buzë, Zgjedhje, Tahir Sinani in 150 - Prizren

(Adresa e subjektit të inspektimit)

Inspektimi është realizuar nga:

Kathina Islami
Leon S. Blazaj

(Emrat dhe mbiemrat e inspektorëve dhe personave të autorizuar për inspektim)

Në numër të dokumentit të identifikimit:

MSI-1060
MSI-0626

(Numri përkatës i dokumentit të identifikimit të inspektorit dhe të personave të autorizuar)

Në informatat kontaktuese:

Kathina Islami@rks-gov.net

(Adresa elektronike e njerit nga inspektorët dhe numri zyrtar kontaktues)

Baza ligjore e inspektimit:

Ligji 04/12-173; Ligji 04/12-190; Ligji 02/12-067; LAMSH/11/2015


Procesverbali përpilohet për:

inspektorat pa planifikim

(Lloji i inspektimit)

Inspektimi është bërë:

me miratim



pa miratim



Inspektimi është bërë pa miratim përshkak të:

(Arsyeja e inspektimit pa miratim)

(Nr. Serik)

Ka munguar personi përfaqësues i subjektit të inspektimit: po ☒ jo ☐

Arsyeja për devijimin e inspektimit nga lista e kontrollit të inspektimit është:

Eshtë inspektuar: Drejtoria e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë
Shërbimi i Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë
(objekti i inspektimit, si për shembull lloji i dokumentacionit, i produktit, i objektit etj.)

(mostrat e produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve, nëse ka ndodhur)

Gjetiet e inspektimit janë: *Karrirologjia u gjet e hapur dhe prezantoi një*
 2. *Bequlla i shantazhezi i famshëm në të cilën kishte*
numër KO-24600 JS-4. Banorja në një të mështullës së
shkëlqyeshme dhe shumë të mirë të shantazhezi të shantazhezi të
shantazhezi të shantazhezi të shantazhezi të shantazhezi të
shantazhezi të shantazhezi të shantazhezi të shantazhezi të
 Pretendimet e subjektit të inspektimit janë: *shantazhezi të shantazhezi të shantazhezi të shantazhezi të*

Subjektid inspektimist ka võrejtje si viion:

(vërejtjet eventuale të subjektit të inspektimit sa i përket gjetjeve të inspektimit)

Vendimet e marra janë si vijon:

Sipas BOMSHC-së dhe përfaqësuesve të vendit, përfundimtarja do të mbahet nën formën e dispozitive
Kujdes se faze për qytetin korrë si përparat në luftë.

Inspektimi ka përfunduar më datë: 13.03.2025, në orën: 11:30

Bjirula Mamej Bey
(nënshkrimi i subjektit të inspektimit apo përfaqësuesit të tij)

(nënshkrimet e anëtarëve të trupës inspektuese)

Kaltrina Islamaj

From: Kaltrina Islamaj
Sent: Thursday, March 13, 2025 8:39 AM
To: 'Albana Nikqi'
Cc: Remzie Thaqi; Leonis Blakaj
Subject: RE: Njoftim

E nderuar,

Në rrjedhë të kërkesës suaj, ju informoj se, inspektimin Praktika e Mirë Farmaceutike mund ta caktojme për një datë tjetër. Për datën e saktë do të ju njoftojmë me kohë.

Me respekt,
Kaltrina Islamaj

From: Albana Nikqi [mailto:nikcialbana@gmail.com]
Sent: Thursday, March 13, 2025 8:19 AM
To: Kaltrina Islamaj
Subject: Re: Njoftim

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Pershendetje, si jeni, jam nga Farmacia AN&BI (Albana Islamaj B.I) Prizren, per sot me keni njoftuar do vini per vizite tek ne per Praktike te Mire, por a mund te me caktoni nje date tjeter ju lutem sepse Farmacistja sot e e mori pushim (sapo me njoftoi) per shkak te ca problemeve te saj private e nuk mundet me ardhe. Prandaj nuk mund ta mbaj hapur sot Farmacin. Ju lutem me ktheni pergjigje.

On Mon, Mar 10, 2025 at 1:13 PM Albana Nikqi <nikcialbana@gmail.com> wrote:

pershendetje, pranova email nga ju, faleminderit

On Mon, Mar 10, 2025 at 1:10 PM Kaltrina Islamaj <Kaltrina.Islamaj@rks-gov.net> wrote:

Të nderuar,

Ju informoj se, bazuar në planin vjetor të punës, me datë 13.03.2025 (e enjte), do të kryhet inspektimi Praktika e Mirë Farmaceutike-PMF në barnatoren "Pharmacy AN & BI" në Prizren.

Të bashkangjitur gjeni:

Njoftimin për inspektim dhe pyetsorin e PMF-ës së bashku me listat përcjellëse.

P.S. Ju lutem konfirmoni pranimin e E-mailit!